



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë -
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry,
Entrepreneurship and Trade

UDHËZIM ADMINISTRATIV(MINT) Nr. 01/2024
PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË TURIZMIT
AKTIV DHE AVENTUROR

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë,

Në mbështetje të nenit 37, paragrafit 4 të Ligjit Nr. 08/L-074 për Turizmin (Gazeta Zyrtare nr. 15/13.06.2022), nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, Shtojcës 12 të Rregullores Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Nenit 38, paragrafit 6 të Rregullores Nr. 09/2011 së Punës së Qeverisë (Gazeta Zyrtare Nr. 15/12.09.2011),

Nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr. 01/2024 PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË TURIZMIT AKTIV DHE AVENTUROR

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen kushtet dhe kriteret e sigurisë që duhet t'i plotësojnë shoqatat profesionale të turizmit dhe shoqëritë tregtare që merren më ofrimin e veprimtarisë së shërbimeve të turizmit aktiv dhe aventuror.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet ndaj shoqatave profesionale të turizmit dhe shoqërive tregtare që merren me ofrimin e veprimtarisë së shërbimeve të turizmit aktiv dhe aventuror.

Neni 3 Kushtet, kriteret dhe detyrimet për ushtrimin e veprimtarisë së turizmit aktiv dhe aventuror

1. Për ushtrimin e veprimtarisë së tyre, shoqatat profesionale të turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofrojnë shërbimet duhet t'i plotësojnë kriteret në vijim:

1.1. të jetë e regjistruar në ARBK në ndonjërin nga format e shoqërive tregtare apo të jetë e regjistruar në Ministrinë përkatëse për regjistrimin e OJQ-ve si shoqatatë profesionale e turizmit aktiv dhe aventuror;

1.2. të regjistrohet në regjistrin e turizmit, sipas Udhëzimit Administrativ përkatës për Regjistrin e Turizmit;

1.3. të kujdeset për aftësimin e vazhdueshëm profesional të stafit, dhe certifikimin e stafit për rastet kur është e aplikueshme për ofrimin shërbime specifike;

1.4. të mbajnë ditar (evidencë) të shërbimeve, i cili posaçërisht përmban të dhëna për:

- 1.4.1. emrin dhe selinë e shoqatës profesionale të turizmit ose shoqërisë tregtare që ofron shërbime të turizmit aktiv dhe aventuror;
- 1.4.2. llojin e shërbimit;
- 1.4.3. listën e stafit të aftësuar profesionalisht i cili është i trajnuar për ofrimin e atij shërbimi (emri dhe mbiemri, numri i dokumentit të identifikimit, vendi dhe data e lindjes, shtetësia, numri i licencës/certifikatës për ofrimin e shërbimit, kualifikimi në përputhje me ligjin dhe standardin);
- 1.4.4. listën e pajisjeve për ofrimin e shërbimit (prodhuesin, origjinën, viti i prodhimit, numri serial);
- 1.4.5. lista kontrolluese ditore, javore, mujore dhe vjetore e pajisjeve që përdoren për ofrimin e shërbimit/eve;
- 1.4.6. udhëzimet për përdorimin e pajisjeve, mirëmbajtje dhe inspektim për shërbimet specifike të ofruara;
- 1.4.7. përdoruesin e shërbimit (emri dhe mbiemri, numri i dokumentit të identifikimit, vendi dhe data e lindjes, shtetësia);
- 1.4.8. aksidentet gjatë ofrimit të shërbimit.

2. Shoqëritë tregtare të cilat regjistrohen në regjistrin e turizmit, sipas Udhëzimit Administrativ përkatës për Regjistrin e Turizmit duhet të plotesojnë kërkesën për regjistrim të shoqërisë tregtare për ofrimin e shërbimeve të turizmit aktiv dhe aventuror në regjistrin e turizmit sipas shtojcës Nr. 6 të këtij udhëzimi administrativ. Ndërsa shoqatat profesionale të turizmit duhet të plotesojnë kërkesën sipas shtojcës Nr. 7 të këtij udhëzimi administrativ.

3. Shoqatat profesionale të turizmit dhe shoqëritë tregtare sipas nenit 37 të Ligjit të Turizmit, para fillimit të ofrimit të shërbimeve, janë të obliguara që:

- 3.1. të kontrollojnë rregullsinë teknike të pajisjes e cila përdoret për ofrimin e shërbimeve të turizmit aktiv dhe aventuror para dhe pas vënies në shfrytëzim;
- 3.2. të kryejnë kontrollin e rregullsisë së vendosjes së pajisjes në personin që përdor shërbimet e turizmit aktiv dhe aventuror nga stafi i trajnuar ose certifikuar;
- 3.3. të përdorin pajisjen në përputhje me udhëzimet / rekomandimet e prodhuesit dhe të mirëmbahen sipas kërkesave teknike dhe të sigurisë;
- 3.4. me rastin e ofrimit të shërbimit, të tregohen se cilat pajisje personale janë të nevojshme për realizimin e sigurt të aktivitetit, i cili ofrohet në kuadër të çmimit të shërbimit që ofron shërbime;
- 3.5. të vendos në pozicion të dukshëm një tabelë informuese lidhur me orarin e punës, çmimet e shërbimeve, rregullat e sigurisë dhe mënyrën e paraqitjes së ankesave për shërbimet e ofruara;
- 3.6. të informojë përdoruesin me shkrim ose me gojë për llojet e rreziqeve që lidhen me ofrimin e shërbimeve, përdorimin e duhur të pajisjeve, vlerësimin e rrezikut dhe planet dhe procedurat e evitimit të rrezikut.

Neni 4

Kushtet minimale-teknike për ofrimin e shërbimeve të ngjitjes

1. Ngjitja në natyrë, si veprimtari turistike, përfshin ngjitjen në struktura natyrore si male, shkëmbinj dhe formacione shkëmbore.

2. Shoqatat profesionale të turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofrojnë shërbime të ngjitjes janë të obliguara të plotësojnë këto kushte të sigurisë për ngjitje:

- 2.1. të sigurohen që pjesëmarrësit të kenë trajnim dhe përvojë adekuate në teknikat e ngjitjes, trajtimin e litarit dhe procedurat e shpëtimit;
- 2.2. të sigurohen që pjesëmarrësit përdorin pajisje të përshtatshme (adekuate) që i plotësojnë kriteret e sigurisë, duke përfshirë helmetat, parzmoret, këpucët për ngjitje, pajisjet mbajtëse për litar (ang. “belay”) dhe karabina;
- 2.3. të sigurohen që pjesëmarrësit të kenë trajnim dhe përvojë adekuate në teknikat e lidhjes së nyjeve të litarit dhe vendosja e sigurt e ankerimit (kanxhës);
- 2.4. të vlerësojnë dhe menaxhojnë rreziqet që lidhen me kushtet e motit, cilësinë e shkëmbinjve, vështirësinë e terrenit dhe rreziqet e mundshme që mund të paraqiten;
- 2.5. të sigurojnë që pjesëmarrësit ndjekin parimet “Mos lë asnjë gjurmë” (ang. “Leave No Trace”), duke respektuar mjedisin dhe duke iu përmbajtur rregulloreve lokale.

Neni 5

Kushtet minimale-teknike për ofrimin e shërbimeve të ecjes në zona malore

1. Ecja në zonat malore, si veprimtari turistike, i referohet aktivitetit rekreativ të shëtitjes ose ecjes nëpër shtigje dhe udhë në rajonet malore.

2. Shoqatat profesionale të turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofrojnë shërbime të ecjes në zonat malore janë të obliguara të plotësojnë këto kushte të sigurisë:

- 2.1. të sigurohen që pjesëmarrësit në ecje në zona malore të jenë të përgatitur në mënyrë adekuate me veshje të përshtatshme, këpucë dhe pajisje të përshtatshme për terrenin malor;
- 2.2. të sigurohen që pjesëmarrësit në ecje në zona malore duhet të kenë mjete navigimi si harta, busulla ose pajisje GPS dhe të kenë njohuri për planifikimin e itinerarit dhe shënimet e shtigjeve;
- 2.3. të informojnë pjesëmarrësit për kushtet e motit para dhe gjatë ecjes në zona malore dhe të rregullojnë planet në përputhje me rrethanat, për t’i shmangur situatat e rrezikshme;
- 2.4. të sigurohen që pjesëmarrësit në ecje në zona malore duhet të mbajnë furnizime emergjente, duke përfshirë një kuti të ndihmës së parë, bilbil, llambë dore, ushqim dhe ujë. Njohja e ndihmës së parë dhe metodave bazë të komunikimit në raste urgjente është thelbësore.

3. Pjesëmarrësit në ecje në zona malore duhet t’i vlerësojnë aftësitë e tyre fizike dhe të zgjedhin shtigje që përputhen me nivelin e tyre të shëndetit fizik.

4. Pjesëmarrësit në ecje në zona malore duhet ta respektojnë mjedisin natyror, t’u përmbahen rregulloreve të shtigjeve dhe t’i hedhin mbeturinat në vendet adekuate. Shmangia e dëmtimit të florës, faunës dhe zonave të mbrojtura është thelbësore.

Neni 6

Kushtet minimale-teknike për ofrimin e shërbimeve të çiklizmit malor

1. Çiklizmi malor, si veprimtari turistike, i referohet aktivitetit rekreativ të ngasjes së biçikletës në shtigje jashtë rrugës dhe në terrene malore.

2. Shoqatat profesionale të turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofrojnë shërbime të çiklizmit malor janë të obliguara të plotësojnë këto kushte të sigurisë:

2.1. të sigurohen që pjesëmarrësit mbajnë një helmetë që plotëson standardet e sigurisë dhe pajisje të përshtatshme mbrojtëse, si p.sh. jastëkët për gjunjë dhe bërryla, si dhe kuti të ndihmës së parë, mjete për riparime të vogla, ujë të mjaftueshëm dhe një pajisje komunikimi;

2.2. të sigurohen që pjesëmarrësit që ngasin biçikletat të kenë aftësi dhe përvojë të përshtatshme për t'i naviguar pengesat, për të performuar teknikat bazë të manovrimit me biçikletë dhe për të reaguar ndaj ndryshimit të konfiguracionit të shtigjeve;

2.3. të zgjedhin shtigje të përshtatshme për ekspertizën me biçikletë malore dhe nivelin e shëndetit fizik, duke marrë parasysh faktorë të tillë si vështirësia, kushtet e shtegut dhe sinjalistika.

3. Biçikletat duhet të mirëmbahen, duke përfshirë frenat, gomat dhe sistemet e amortizimit, për të siguruar funksionim të sigurt në terrene sfiduese.

4. Pjesëmarrësit në çiklizmin malor duhet ta respektojnë mjedisin natyror, t'u përmbahen rregulloreve të shtigjeve dhe t'i hedhin siç duhet mbeturinat. Shmangia e dëmtimit të florës, faunës dhe zonave të mbrojtura është thelbësore.

Neni 7

Kushtet minimale-teknike për ofrimin e shërbimeve të parashutizmit

1. Shërbimet e kërcimit me parashutë janë:

1.1. kërcimi tandem me parashutë (kërcimi në të njëjtën kohë i dy (2) personave), dhe

1.2. fluturimi tandem me paraglider.

2. Kërcimi tandem me parashutë është aktivitet që kryhen me kërcim me një parashutë, me të cilën zbresin dy (2) persona të ndërlidhur mes veti me sistemet e lidhjes, njëri prej të cilëve duhet të ketë leje parashutisti në përputhje me rregulloren e posaçme për kryerjen e kërcimeve tandem dhe që drejton kërcimin.

3. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëria tregtare që ofron shërbime të kërcimit tandem me parashutë duhet të ketë pajisjet dhe mjetet vijuese:

3.1. parashutë tandem me pajisjet përkatëse;

3.2. helmetë;

3.3. parashutë rezervë;

3.4. radiolidhje; dhe

3.5. rripin për shpëtim, nëse kërcimi bëhet mbi sipërfaqe ujore.

4. Fluturimi tandem me paraglider është aktivitet që nënkupton fluturim me një paraglider në të cilin gjinden dy (2) persona të ndërlidhur me sisteme lidhjeje, njëri prej të cilëve duhet të ketë lejen e pilotit të paragliderit në përputhje me rregullore të veçantë për kryerjen e fluturimeve tandem dhe që drejton fluturimin e paragliderit.

5. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëria tregtare që ofron shërbime të fluturimit tandem me paraglider duhet të ketë pajisjet dhe mjetet vijuese:

- 5.1. paraglajder tandem me pajisje përkatëse;
- 5.2. helmetë;
- 5.3. pajisje për matjen e lartësisë së fluturimit, në përputhje me rregullore të veçantë;
- 5.4. parashutë rezervë;
- 5.5. radiolidhje; dhe
- 5.6. rripin për shpëtim, nëse fluturimi bëhet mbi sipërfaqe ujore.

6. Pjesëmarrësit duhet t'i nënshtrohen trajnimit dhe certifikimit të duhur nga organizata ose instruktorë të njohur të parashutizmit.

7. Mjeti ajror i përdorur për parashutizëm duhet t'i përmbushë standardet e sigurisë dhe të operohet nga personeli i kualifikuar.

8. Parashutizmi duhet të kryhet në zona të caktuara të kërcimit të cilat i plotësojnë kërkesat e sigurisë, duke përfshirë zonat adekuate të uljes dhe hapësirën e lirë ajrore.

9. Parashutistët duhet të jenë në gjendje të mirë fizike dhe ta shpalosin çdo problem të mundshëm shëndetësor që mund të ndikojë në aftësinë e tyre për të marrë pjesë në mënyrë të sigurt.

10. Parashutistët duhet të kenë njohuri për procedurat e urgjencës, duke përfshirë dështimet në aktivizimin (ang. “deployment”) e parashutës dhe si të trajtojnë situata të papritura gjatë kërcimit dhe uljes

11. Parashutizmi duhet të kryhet vetëm në kushte të përshtatshme moti, duke pasur parasysh shpejtësinë e erës, dukshmërinë dhe faktorë të tjerë përkatës.

Neni 8

Kushtet minimale-teknike për ofrimin e shërbimeve të alpinizmit

1. Alpinizmi, si veprimtari turistike, i referohet aktivitetit rekreativ të ngjitjes në male dhe përfshirjes në ekspedita alpinistike.

2. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëria tregtare që ofron shërbime të alpinizmit janë të obliguar të plotësojnë këto kushte të sigurisë për alpinizëm:

- 2.1. të sigurojë që pjesëmarrësit të kenë trajnim dhe përvojë të përshtatshme në teknikat e ngjitjes alpine, planifikimin e itinerarit dhe përshtatjen ndaj klimës në lartësi të mëdha;

- 2.2. të sigurojë që pjesëmarrësit të përdorin pajisje të specializuara si litar, parzmore, pafta me thumba (ang. "crampons"), sëpata për akull, helmata dhe veshje mbrojtëse të përshtatshme për mjedisin alpin;
- 2.3. të informojnë pjesëmarrësit për kushtet e motit, duke përfshirë ndryshimet në temperaturë, shpejtësinë e erës dhe stuhitë e mundshme, dhe të rregullojnë planet në përputhje me rrethanat;
- 2.4. të sigurojnë që pjesëmarrësit të kenë aftësi navigimi për t'i vlerësuar rrugët, për t'i identifikuar rreziqet e mundshme dhe për të marrë vendime të mbështetura në informata, duke u bazuar në kushtet aktuale;
- 2.5. të vlerësojë dhe menaxhojë rreziqet që lidhen me terrene të pjerrëta, çarje të thella, ortekë dhe rreziqe të tjera që zakonisht hasen në mjediset alpine;
- 2.6. të sigurojë që pjesëmarrësit ngjiten në ekipe, duke mbajtur komunikim të qartë dhe duke praktikuar punën ekipore për të garantuar siguri dhe ndihmë reciproke gjatë situatave sfiduese;
- 2.7. të sigurojë që pjesëmarrësit mbajnë pajisje thelbësore të sigurisë, duke përfshirë kutitë e ndihmës së parë, pajisjet e komunikimit emergjent dhe pajisjet e mbijetesës, si dhe të kenë njohuri për reagimin ndaj emergjencave dhe procedurat e evakuimit.

Neni 9

Kushtet minimale-teknike për ofrimin e shërbimeve të lundrimit në ujëra të rrëmbyeshëm

1. Lundrimi në ujërat e rrëmbyeshëm është aktiviteti i ofrimit të shërbimeve të lëvizjes përmes ujërave të rrëmbyeshëm, përkatësisht shtratit të lumit.
2. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëria tregtare që ofron shërbime të kalimit nëpër shtratin e lumit me ujëra të rrëmbyeshëm duhet të ketë pajisjet dhe mjetet vijuese:
 - 2.1. helmata;
 - 2.2. rripin për zbritje në shtratin e lumit të rrëmbushëm;
 - 2.3. litar statik;
 - 2.4. kostum zhytjeje;
 - 2.5. rrip për shpëtim;
 - 2.6. pykë për siguri me rastin e zbritjes në shtratit të lumit;
 - 2.7. ndihmën e parë;
 - 2.8. radio stacione;
 - 2.9. çantë shpine me pajisje për lundrim të destinuar për udhërrëfyes;
 - 2.10. doreza për lundrim; dhe
 - 2.11. këpucë për lundrim.
3. Shoqatat profesionale të turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofrojnë shërbime të lundrimit në ujëra të rrëmbyeshëm janë të obliguara të plotësojnë këto kushte të sigurisë:
 - 3.1. të ofrojnë për pjesëmarrësit informata gjithëpërfshirëse për sigurinë përpara udhëtimit të lundrimit në ujëra të rrëmbyeshëm, duke përfshirë udhëzimet për teknikat e manovrimit me lopata, sinjalet e lundrimit në ujëra të rrëmbyeshëm dhe procedurat e urgjencës;
 - 3.2. të informojnë pjesëmarrësit për nivelin e vështirësisë së lumit dhe të zgjedhin itinerar që përputhet me nivelin e tyre të aftësisë;

3.3. lundrimi në ujëra të rrëmbyeshëm duhet të kryhet në kushte të përshtatshme moti, duke pasur parasysh nivelet e ujit, rrymat dhe rreziqet e mundshme.

4. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëria tregtare, para fillimit të ofrimit të shërbimit të kalimit nëpër ujërat e rrëmbyeshëm, duhet t'i jep instruksione të veçanta personit që përdor shërbimet rreth mënyrës së veprimit në ujërat e rrëmbyeshëm, përkatësisht gjatë vizitës (turneut) të gjithmbarshëm në ujërat e rrëmbyeshëm.

5. Për grupet e organizuara të personave që përdorin shërbimin e kalimit nëpër ujëra të rrëmbyeshëm, shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëria tregtare duhet të ketë për grup deri në dhjetë përdorues të shërbimeve, dy (2) persona të aftësuar profesionalisht me certifikatë për ofrimin e atyre llojeve të shërbimeve, kurse për çdo dhjetë persona të rinj që përdorin shërbimin, edhe nga një person i aftësuar profesionalisht.

Neni 10

Kushtet minimale-teknike për ofrimin e shërbimeve të lundrimit me kajak

1. Lundrimi me kajak si veprimtari turistike, i referohet aktivitetit rekreativ të lundrimit në trupa ujorë duke përdorur një mjet të vogël ujor të ngushtë, të njohur si kajak.

2. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëria tregtare që ofron shërbime të lundrimit në kajak duhet të përdorin kajakë që janë në gjendje të mirë, të përshtatshme për kushtet e parashikuara të ujit dhe të pajisura me pajisjet e nevojshme të sigurisë, si p.sh. lopata, anësore me spërkatje (ang. "spray skirts") dhe linja sigurie (ang. "safety lines").

3. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofron shërbime të lundrimit me kajak janë të obliguar të plotësojnë këto kushte të sigurisë:

3.1. të sigurojnë që pjesëmarrësit duhet të kenë aftësi dhe përvojë adekuate të përdorimit të lopatave për lundrim, duke përfshirë aftësinë për të manovruar kajakun, për të kryer teknika të vetëshpëtimit dhe për t'i trajtuar kushtet e ndryshme të ujit;

3.2. të sigurojnë që lundrimi me kajak duhet të kryhet në kushte të përshtatshme moti, duke pasur parasysh shpejtësinë e erës, valët, rrymat dhe ndryshimet e mundshme të motit gjatë aktivitetit;

3.3. të sigurojnë që pjesëmarrësit të jenë të familjarizuar me mjetet ndihmëse të lundrimit, hartat dhe rregullat e lundrimit për të lundruar në mënyrë të sigurt në trupat ujorë dhe për t'iu shmangur rreziqeve të mundshme.

Neni 11

Kushtet minimale-teknike për ofrimin e shërbimeve të aktiviteteve speleologjike

1. Aktivitetet speleologjike, si veprimtari turistike, i referohen eksplorimit dhe zbulimit të shpellave dhe sistemeve nëntokësore.

2. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëria tregtare që ofron shërbime të aktiviteteve speleologjike janë të obliguar t'i plotësojnë këto kushte të sigurisë për aktivitetet speleologjike:

- 2.1. të sigurohen që pjesëmarrësit të përdorin pajisje të përshtatshme sigurie, duke përfshirë helmata, llamba të kokës ose të dorës, këpucë të forta dhe veshje mbrojtëse për të garantuar sigurinë personale dhe për ta minimizuar rrezikun e lëndimit;
- 2.2. të kryejnë vlerësime të plota të kushteve të shpellave, duke përfshirë cilësinë e ajrit, stabilitetin strukturor, nivelet e ujit dhe rreziqet e mundshme përpara se të lejojnë qasjen për pjesëmarrësit;
- 2.3. të ofrojnë për pjesëmarrësit informata gjithëpërfshirëse mbi sigurinë, duke përfshirë udhëzimet për navigimin në shpellë, rreziqet e mundshme, procedurat e emergjencës dhe përdorimin e duhur të pajisjeve;
- 2.4. aktivitetet speleologjike duhet të kryhen në grupe të vogla për ta lehtësuar komunikimin efektiv, mbikëqyrjen dhe reagimin e shpejtë në rast emergjencash;
- 2.5. nëse hasen seksione vertikale ose kalime sfiduese, punonjësit e operatorit turistik, shoqëritë tregtare, dhe personat tjerë juridike duhet të sigurojnë se pjesëmarrësit kanë njohuri dhe përvojë adekuate në teknikat me litar për zbritje dhe ngjitje të sigurta.

3. Aktivitetet speleologjike duhet të udhëhiqen nga speleologët të kualifikuar dhe me përvojë, të cilët zotërojnë njohuri adekuate për sistemet e shpellave, procedurat e sigurisë dhe teknikat e shpëtimit.

Neni 12

Kushtet minimale-teknike për ofrimin e shërbimeve të aktiviteteve të kalërimit

1. Kalërimi, si veprimtari turistike, i referohet aktivitetit rekreativ të kalërimit.
2. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofron shërbime të kalërimit duhet të plotësojnë këto kushte të sigurisë për kalërim:
 - 2.1. të sigurojnë që pjesëmarrësit të përdorin veshje të përshtatshme mbrojtëse, duke përfshirë helmata, këpucë të forta me taka dhe pajisje të tjera sigurie sipas nevojës;
 - 2.2. të sigurojnë që pjesëmarrësit të kenë aftësi dhe përvojë të përshtatshme kalërimi për ta kontrolluar dhe trajtuar në mënyrë të sigurt kalin, duke përfshirë njohuri për teknikat bazë të kalërimit, komandat dhe sjelljen e kalit;
 - 2.3. të sigurojnë që kuajt të jenë të përshtatshëm për nivelin e aftësive dhe temperamentin e kalorësit, duke siguruar një përvojë të sigurt dhe të rehatshme kalërimi;
 - 2.4. të ofrojnë për pjesëmarrësit informata gjithëpërfshirëse mbi sigurinë, duke përfshirë udhëzime për montimin dhe çmontimin, përdorimin e duhur të frenave dhe ndërgjegjësimin për rreziqet e mundshme;
 - 2.5. të sigurojnë që pjesëmarrësit fillestarë ose të papërvojë, të jenë të mbikëqyruar nga personeli i kualifikuar i cili mund të ofrojë udhëzime dhe të garantojë sigurinë e tyre gjatë aktivitetit;
 - 2.6. të sigurojnë që pjesëmarrësit respektojnë mjedisin natyror, t'u përmbahen shtigjeve të përcaktuara, ta shmangin dëmtimin e bimësisë dhe t'i hedhin siç duhet mbeturinat.

Neni 13

Kushtet minimale-teknike për ofrimin e shërbimeve të aktiviteteve të ngjitjes në shkëmbinj

1. Ngjitja në shkëmbinj, si veprimtari turistike, i referohet aktivitetit rekreativ të ngjitjes së formacioneve shkëmbore duke përdorur pajisje dhe teknika të specializuara.

2. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofron shërbime të ngjitjes në shkëmbinj duhet të ketë pajisjet dhe mjetet vijuese:

2.1. helmata;

2.2. parzmore (ang. “harnesses”);

2.3. litar;

2.4. karabina dhe

2.5. këpucë për ngjitje,

2.6 të gjitha pajisjet e përshkruara në paragrafin 2 të këtij neni duhet t’i përmbushin standardet e njohura të sigurisë.

3. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofron shërbime të ngjitjes në shkëmbinj duhet të plotësojnë këto kushte të sigurisë për ngjitje në shkëmbinj:

3.1. të sigurohen që pjesëmarrësit të kenë aftësi adekuate të ngjitjes, duke përfshirë njohuritë e teknikave bazë të ngjitjes, menaxhimin e litarit dhe aftësinë për t’i vlerësuar kushtet e shkëmbinjve dhe rreziqet e mundshme;

3.2. të ofrojnë për pjesëmarrësit informata gjithëpërfshirëse mbi sigurinë, duke përfshirë udhëzimet për përdorimin e duhur të pajisjeve, sinjalet e ngjitjes, metodat e komunikimit dhe ndërgjegjësimin për rreziqet e mundshme;

3.3. të vlerësojnë rreziqet që lidhen me rrugët dhe terrene të pjerrëta, duke përfshirë nivelin e vështirësisë, qëndrueshmërinë e shkëmbinjve dhe rreziqet e mundshme si shkëmbinj të lirshëm ose shkëmbinj të pjerrët (ang. “overhanging”);

3.4. të sigurojnë që pjesëmarrësit respektojnë mjedisin natyror, ta shmangin dëmtimin e formacioneve shkëmbore ose vegjetacionit dhe t’u përmbahen rregulloreve në lidhje me zonat e mbrojtura.

4. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofron shërbime të ngjitjes në shkëmbinj duhet t’i mbajnë pajisjet e nevojshme të sigurisë që i përmbushin standardet adekuate të sigurisë, duke përfshirë një kuti të ndihmës së parë, pajisje komunikimi dhe njohuri për teknikat bazë të ndihmës së parë dhe të vetë-shpëtimit.

Neni 14

Kushtet minimale-teknike për ofrimin e shërbimeve të rrëshqitjes në litar dhe kurseve me litar

1. Rrëshqitja në litar dhe kurset me litar, si veprimtari turistike, i referohet aktivitetit rekreativ të argëtimit që përfshinë aktivitetet që zhvillohen mbi lartësinë e tokës të tilla si parku i aventurave, zipline, gjigantet lëkundës (giant swing), rënia e lirë (free fall), etj duke përdorur pajisje dhe teknika të specializuara.

2. Shoqata profesionale e turizmit dhe shoqëria tregtare që ofron shërbime të rrëshqitjes në litar dhe kurse me litar duhet të ketë pajisjet dhe mjetet vijuese:

- 2.1. helmeta;
 - 2.2. rripat e sigurisë (ang. “Harnesses”);
 - 2.3. karabinat dhe lidhëset (ang. “Carabiners and connectors”);
 - 2.4. pajisjet mbajtëse (ang. “Belay devices”);
 - 2.5. pajisjet zbritëse (ang. “Descending devices”);
 - 2.6. pajisjet ngritëse (ang. “Ascending devices – rope clamps”);
 - 2.7. pajisjet për parandalimin nga rënia (ang. “Fall arrest device – ASAP”);
 - 2.8. pulexhot (ang. “pulleys”);
 - 2.9. litar dhe absorbues energjie (ang. “Lanyards and energy absorber”);
 - 2.10. pajisje ankorimi (ang. “Anchor devices”);
 - 2.11. litart (ang. “ropes”).
3. Pajisjet që shfrytëzohen për shërbimet e rrëshqitjes me litar dhe kurset me litar duhet ta posedojnë **CE** markën të shoqëruar me Deklaratën e Komformitetit që tregon se pajisja/et i plotëson kërkesat e Rregullores përkatëse për Pajisje Personale Mbrojtëse.
4. Shoqatat profesionale të turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofrojnë shërbime të rrëshqitjes në litar dhe kurseve të litarve për pajisjet që i posedojnë duhet t’i përdorin sipas udhëzimeve të prodhuesit, t’i bëjnë kontrollet para, gjatë dhe pas përdorimit nga shfrytëzuesi; mirëmbajtja dhe deponimi të jetë adekuat.
5. Kushtet për ofrimin e aktiviteteve të rrëshqitjeve në litar dhe kurset me litar do të rregullohen me aneks të veçantë, aneks ky i cili do të jetë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi administrativ.

Neni 15

Mbikëqyrja e zbatimit të Udhëzimit Administrativ

Mbikëqyrja e zbatimit të këtij udhëzimi administrativ i cili ndërlidhet me shërbimet e turizmit aktiv dhe aventuror duhet të ushtrohet nga inspektorati kompetent i tregut në kuadër të ministrisë përgjegjëse për industri, ndërmarrësi dhe tregti.

Neni 16

Shtojcat e Udhëzimit Administrativ

1. Shtojcat që i janë bashkëngjitur këtij udhëzimi administrativ, janë pjesë përbërëse e tij:
 - 1.1. Shtojca 1 e Udhëzimit Administrativ për ofrimin e shërbimeve të rrëshqitjes në litar dhe kurseve me litar.
 - 1.2. Shtojca 2 Formulari i raportimit të aksidenteve dhe incidenteve;
 - 1.3. Shtojca 3 Regjistri i inspektimit ditor - Via Ferrata;
 - 1.4. Shtojca 4 Regjistri i inspektimit ditor – Parku i Aventurave;

1.5. Shtojca 5 Regjistri i inspektimit ditor – Zip Line;

1.6. Shtojca 6 Kërkesë për regjistrim të shoqërisë tregtare për ofrimin e shërbimeve të turizmit aktiv dhe avanturor në regjistrin e Turizmit;

1.7. Shtojca 7 Kërkesë për regjistrim të shoqatave profesionale për ofrimin e shërbimeve të turizmit aktiv dhe avanturor në regjistrin e turizmit.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Rozeta Hajdari

Ministre

28 shkurt 2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

**SHTOJCA 1 E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË
RRËSHQITJES NË LITAR DHE KURSEVE ME LITAR DHE VIA FERRATA**

Neni 1

Fushëveprimi dhe Zbatueshmëria e kësaj Shtojce

Me këtë Shtojcë, përpos kritereve të përcaktuara në nenin 14 të këtij Udhëzimi Administrativ përcaktohen edhe kërkesat, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë shoqatat profesionale të turizmit dhe shoqëritë tregtare që ofrojnë shërbime të turizmit aktiv dhe aventuror të rrëshqitjeve me litar dhe kurseve me litar si dhe Via Ferrata.

Neni 2

Përkufizimet

1. Me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të kësaj Shtojce të Udhëzimit Administrativ për ofrimin e shërbimeve të rrëshqitjes në litar dhe kurseve me litar do të aplikohen përkufizimet e mëposhtme:

- 1.1. **“Pajisja belay”** është pajisje për të cilën përdoruesi është i lidhur për të kufizuar distancën nga rënia dhe/ose për të parandaluar lëndimin nga rënia;
- 1.2. **“Personi kompetent”** është personi që ka njohuri dhe përvojë të tillë praktike dhe teorike për pajisjet, të cilat do të ekzaminohen tërësisht, dhe të cilat do t'i mundësojnë atij/asaj të zbulojë defekte ose dobësi, e që është edhe qëllimi i ekzaminimit për të zbuluar dhe vlerësuar rëndësinë e tyre për sigurinë e pajisjes;
- 1.3. **“Udhëzime”** janë informacione të lëshuara zakonisht nga trupat profesionale ose tregtare për të ndihmuar në interpretimin dhe zbatimin e rregulloreve, legjislacionit, standardeve;
- 1.4. **“Legjislacioni”** është kërkesë ligjërish e detyrueshme, fushëveprimi i së cilës përshkruhet në secilin dokument;
- 1.5. **“PPM”** nënkupton pajisjet personale mbrojtëse, siç janë rripat e sigurisë që përdoren nga një përdorues i vetëm, së bashku me një sistem frenimi ose pengues të rënies;
- 1.6. **“Kurse litarësh”** Standardi SK EN 15567, e përkufizon këtë si “një objekt të ndërtuar që përbëhet prej një ose më shumë sistemesh të aktivitetit, sistem mbështetës dhe nëse është e

nevojshme, pajisje belay dhe/ose sistem sigurie.” Kursi me litar dallon prej pajisjeve të këndit të lojërave në atë që ka qasje të kufizuar dhe kërkon mbikëqyrje;

1.7. “**Standard**” është Standardi Kosovar (SK), Standardi Ndërkombëtar (ISO), Standardi Evropian (EN), ku që të gjitha prej tyre pasqyrojnë teknologjinë më të fundit, dhe megjithëse nuk janë të detyrueshme, ato veprojnë si pikë referimi për praktikat më të mira të industrisë;

1.8. “**Standardi SK EN 15567**” nënkupton: Kurset e litarëve duhet të jenë në përputhje me botimin e fundit të standardit;

SK EN 15567-1 (përfshirë amadamentet e mundshme), Sporte dhe mjedise rekreative (argëtuese) - Kurset e litarve - Pjesa 1: Ndërtimi dhe kërkesa sigurie; dhe

SK EN 15567-2 (përfshirë amadamentet e mundshme), Sporte dhe mjedise rekreative (argëtuese) - Kurset e litarëve - Pjesa 2: Kërkesat operationale.

1.9. “**Standardi SK EN-16869**” nënkupton standardin për dizajnimin dhe ndërtimin e Via Ferrata;

1.10. “**Zipline**” është një sistem i aktivitetit në të cilin pjesëmarrësi rrëshqet nën veprimin e forcës së gravitetit në drejtim të pjerrët. Këto mund të njihen edhe si kablllo çeliku (Zip wires), Pista Ajrore, Dhelpa Fluturuese apo emertime të tjera. Zipline është një aktivitet rekreativ ku pjesëmarrësit, duke përdorur një kablllo të përhershme ose një linjë litari të varur midis strukturave mbështetëse, i mundëson pjesëmarrësit të lidhur në një pulexhë të përshkojë distancën nga një pikë në pikën tjetër, me qëllim që pjesëmarrësve t'u ofrohet dëfrim, kënaqësi, drithërimë ose ngazëllim;

1.11. “**Via Ferrata**” nënkupton një linjë, përgjithësisht e përbërë nga një instalim fiks ngjitje, duke përfshirë një rrugë sigurie ku përdoruesi nuk mbikëqyret;

1.12. “**Operator**” nënkupton çdo shoqatë profesionale të turizmit, shoqëri tregtare, person, partneritet, korporatë ose subjekt tjetër komercial dhe agjentët, zyrtarët, punonjësit ose përfaqësuesit e tyre, të cilët kanë përgjegjësi operationale për secilin kurs litarsh;

1.13. “**Pjesëmarrës**” nënkupton çdo person që përfshihet në aktivitete me një kurs litarsh, qoftë të vetëm ose si pjesë e aktivitetit grupor të mbikëqyrtur nga një operator turistik i kursit litarsh;

1.14. “**Inspektim vizual rutinor**” nënkupton inspektimin që ka për qëllim të identifikojë rrezikun e dukshëm që mund të rezultojë nga vandalizmi, përdorimi ose moti i ligë;

1.15. “**Inspektim operacional**” nënkupton një inspektim më të detajuar sesa inspektimi vizual rutinor, për të kontrolluar funksionimin dhe gjendjen e pajisjes;

1.16. “**Inspektimi inaugurues**” realizohet pas përfundimit të të gjitha testeve në lidhje me kursin e litarve përpara se parku të hapet për shfrytëzim nga klientët. Ky inspektim kryhet nga një trupë inspektuese ose inspektor certifikues;

1.17. “**Inspektimi periodik**” nënkupton verifikimin e kryer nga një trupë inspektuese ose inspektor certifikues të paktën një herë brenda vitit kalendarik dhe brenda një intervali maksimal prej 15 muajsh për ta kontrolluar funksionimin dhe stabilitetin e pajisjes në kursin e litarve;

1.18. “**Inspektim i jashtëzakonshëm**” nënkupton verifikimin e kryer nga një trupë inspektuese ose inspektor certifikues në rastin kur ka modifikime të mëdha të kursit me litar ose me rastin e ndodhjes së aksidentit;

1.19. “**Trupë inspektuese**” nënkupton një kompani ose individ që kryen inspektimin inaugurues, periodik dhe të jashtëzakonshëm. Standardi SK EN ISO/IEC 17020 përcakton trupat inspektues si të tipit A, tipit B dhe tipit C, të cilat mbulohen nga sigurimi adekuat i përgjegjësisë profesionale. Klasifikimi A, B, C tregon nivelin e pavarësisë jo të kompetencës;

1.20. “Akreditimi” – nënkupton vërtetimin nga një trup kombëtar i akreditimit që trupi inspektues i plotëson kërkesat e përcaktuara nga standardet e harmonizuara dhe kur është e aplikueshme, çfarëdo kërkesa tjera shtesë përfshirë ato të përcaktuara në skemat relevante sektoriale, për kryerjen e aktiviteteve specifike për vlerësimin e konformitetit.

Neni 3 **Detyrimet e Ndërtuesve**

1. Ndërtuesi ose instaluesi i strukturës së re të aktivitetit me kurse me litarsh duhet të sigurojë manualin e produktit që përmban së paku informacionet e mëposhtme.

- 1.1. Përshkrimin teknik të objektit dhe komponentëve të tij individualë (certifikata marciale, etj.);
- 1.2. Udhëzimet lidhur me përdorimin e saktë të kursit sipas të dy (2) pjesëve të SK EN 15567 dhe specifikimeve për të gjitha PPM-dhe pajisjet përkatëse të sigurisë;
- 1.3. Certifikatën e konformitetit sipas SK EN 15567.

2. Deklarata e konformitetit të prodhuesit duhet të përmbajë si në vijim:

- 2.1. Llogaritjet e projektimit;
- 2.2. Referencat normative;
- 2.3. Përjashtimet e përgjegjësisë, nëse ka
- 2.4. Udhëzimet për mirëmbajtjen, që specifikojnë shpeshësinë dhe metodën me të cilën pajisja inspektohet dhe mirëmbahet.

Neni 4 **Detyrimet e operatorëve**

1. Operatori i kurseve me litar do të jetë përgjegjës për përdorimin dhe mirëmbajtjen e sigurt të Kursit me litar në përputhje me udhëzimet për përdorim dhe mirëmbajtje, të lëshuara nga prodhuesi dhe instaluesi, si dhe me standardet e aplikueshme.

2. Operatori i kurseve me litar është i obliguar të:

- 2.1. Ndërtojë, instalojë, mirëmbajë dhe operojë me të gjithë kurset me litar në përputhje me udhëzimet e prodhuesit për përdorimin, inspektimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve, me standardin SK EN 15567 dhe standardet tjera që në masë të madhe janë të barasvlershme;
- 2.2. Garantojë që kurset me litar të inspektohet të paktën çdo vit nga inspektori i posaçëm certifikuar (personi kompetent) ose nga një trupë inspektuese;
- 2.3. Trajnojë punonjësit që operojnë me kurse me litar në përputhje me standardet kosovare (SK), standardet ndërkombëtare (ISO), standardet evropiane (EN) dhe standardet që lidhen me profesionin e tyre.

Neni 5 **Detyrimet dokumentare për operatorin**

1. Operatori duhet të sigurojë posedimin e dokumentacionit në vijim:

1.1. Emri dhe adresa e pronarit dhe e Operatorit.

1.2. Dokumenti që tregon kryerjen e inspektimit nga një trupë inspektuese apo inspektor i certifikuar.

1.3. Lista e personelit në vendndodhje, funksioni dhe kualifikimi/kompetenca e tyre.

1.4. Shënimet e inspektimeve ditore.

1.5. Raportet e aksidenteve dhe incidenteve.

1.6. Vlerësimi i rrezikut dhe plani i menaxhimit të rrezikut, që do të hartohen nga Operatori i aktiviteteve të aventurës mbi tokë.

1.7. Mbajtja e shënimeve për një periudhë prej së paku pesë (5) viteve, nga data e krijimit të shënimit.

Neni 6

Pajisjet personale mbrojtëse

1. Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM) të përdorura duhet të jenë në pajtim me kërkesat e Rregullores përkatëse për Pajisje Personale Mbrojtëse.

2. Kur personat që kryejnë të gjitha punët ndërtimore, mirëmbajtjen dhe inspektimin punojnë në kursin me litar, ata duhet të përdorin pajisje personale mbrojtëse në pajtim me kërkesat e Rregullores për Pajisje Personale Mbrojtëse.

Neni 7

Ndihma e parë

1. Operatori është përgjegjës për të siguruar që lokacioni i kurseve me litar t'i ketë pajisjet e nevojshme të ndihmës së parë, furnizimet, objektet dhe personat për të trajtuar pjesëmarrësit nëse lëndohen gjatë përdorimit të kurseve me litar.

2. Kutia e ndihmës së parë duhet të ketë pajisje bazë për dhënien e ndihmës së parë për lëndimet, duke përfshirë: prerjet, gërvishtjet, shpimet, gërvishtjet e lëkurës dhe therja me ashkla - ndrydhjet dhe tendosjet muskulore - djegiet e vogla, amputimet dhe/ose plagët e mëdha me gjakderdhje - kockat e thyera - lëndimet e syve, dhe – tronditjet.

3. Punonjësi duhet të trajnohet për t'i dhënë ndihmën e parë personave të lënduar në raste të jashtëzakonshme.

4. Trajnimi i punonjësve të operatorit nga paragrafi 3 i këtij neni kryhet nga Kryqi i Kuq, institucionet shëndetësore dhe kompanitë që zhvillojnë veprimtari të mjekësisë së punës dhe specialistët e mjekësisë së punës.

Neni 8 **Obligimet e operatorëve për trajnimin e punonjësve**

1. Operatori duhet të trajnojë punonjësit për:

- 1.1. Identifikimin e rënies ose rreziqet tjera, duke përfshirë përdoruesit që lëvizin poshtë kurseve me litar;
- 1.2. Inspektimin, testimin dhe përdorimin e sistemeve të mbrojtjes nga rënia dhe të pajisjeve mbrojtëse.
- 1.3. Ofrimin e shërbimeve të kërkim-shpëtimit
- 1.4. Gjithnjë të lidhen me një rrip sigurie ose të ankorohen kur punojnë në lartësi;
- 1.5. Ndjekjen e udhëzimeve të prodhuesit për përdorimin, mirëmbajtjen dhe inspektimin e pajisjeve;
- 1.6. Njohjen dhe raportimin e defekteve të pajisjeve;
- 1.7. Ndërveprimi në mënyrë të sigurt me përdoruesit e kurseve me litar (p.sh. drejtimi dhe kapja, si dhe operacionet e shpëtimit);
- 1.8. Drejtimin e kursit në mënyrë të sigurt sipas politikës së kompanisë.

Neni 9 **Obligimet e operatorëve për mirëmbajtjen e pajisjeve**

1. Operatori duhet të bëjë:

- 1.1. Kontrollimin e vendit të punës për rreziqet e mundshme në vendin e punës;
- 1.2. Mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve;
- 1.3. Sigurimin e mjeteve të sigurta për qasje në platformë;
- 1.4. Kontrollimin e rregullt të platformave dhe kurseve me litar (p.sh., përpara çdo turni të punës dhe para çdo përdorimi) për të identifikuar dhe për të rregulluar kushtet e pasigurta;
- 1.5. Sigurimin e pajisjeve mbrojtëse që i përshtaten si duhet çdo punëtori, dhe të jenë në gjendje të mirë pune;
- 1.6. Sigurimin e instalimit, përdorimit dhe mirëmbajtjes së duhur të sistemeve të mbrojtjes nga rënia;
- 1.7. Udhëzimin e pjesëmarrësve për procedurat e kurseve me litar që kanë për qëllim t'i mbajnë punëtorët të sigurtë.

Neni 10 **Obligimi i pjesëmarrësve dhe aktet e ndaluara**

1. Është detyrë e secilit pjesëmarrës që të respektojë udhëzimet e sigurisë së operatorit.

2. Pjesëmarrësit kanë për detyrë të veprojnë siç do të sillej një person i arsyeshëm dhe i matur kur agazhohen në aktivitetet e kurseve me litar të ofruara nga një operator.

3. Pjesëmarrësve u ndalohet të ndërmarrin veprimet e mëposhtme;

- 3.1. Përdorimi i kurseve me litar pa autorizim, mbikëqyrje dhe udhëzime të operatorit të kurseve me litar;
- 3.2. Të lëshojnë, hedhin ose të nxjerrin ndonjë objekt nga kurset me litar ose me përjashtim të rasteve të autorizuara nga operatori;
- 3.3. Të kryejnë ndonjë veprim që ndërhyt në funksionimin ose operimin e një kursi me litar; ose
- 3.4. Të përfshihen në ndonjë çdo sjellje të dëmshme, ose të përfshihen me dashje ose nga pakujdesia në ndonjë lloj sjelljeje që ndikon në shkaktimin e lëndimeve ndaj ndonjë personi.

Neni 11

Përgjegjësia e operatorëve të Kursit me Litar

1. Operatori do të mbahet përgjegjës për lëndimin, humbjen ose dëmin e shkaktuar nga moszbatimi i detyrave dhe standardeve të kujdesit, të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ dhe në dy (2) pjesët e standardit SK EN 15567 kur shkelja e detyrës lidhet shkaktimisht me lëndimin, humbjen ose dëmin e pësuar.
2. Operatori nuk mbahet përgjegjës për ndonjë lëndim, humbje ose dëmtim të shkaktuar nga neglizhenca e ndonjë personi që nuk është agjent ose punonjës i operatorit.

Neni 12

Inspektimi Inaugurues

1. Operatori nuk ka të drejtë të operojë me kurset me litar pa inspektim inaugurues. Inspektimi inaugurues duhet të bëhet nga një trupë inspektuese, (tipi A, në përputhje me standardin SK EN ISO/IEC 17020).
2. Inspektimi inaugurues përfshin kryerjen e kontrolleve të mëposhtme:
 - 2.1. Inspektimin vizual;
 - 2.2. Inspektimet funksionale;
 - 2.3. Rishikimin për të siguruar se ekziston llogaritja e projektimit dhe/ose vlerësimi i forcës së drurit;
 - 2.4. Verifikimin se kursi me litar është ndërtuar në përputhje me skicat e projektimit. Kjo referohet si një Vlerësim i Konformitetit me Dizajnin;
 - 2.5. Një testim funksional i kryer në lartësi nga një inspektor i cili ka njohuri të plotë për kursin me litar dhe mënyrën e përdorimit. Inspektori duhet të jetë gjithashtu i kualifikuar dhe kompetent për të punuar në lartësi.
3. Për inspektimin inaugurues do të përgatitet një raport inspektimi që përmban informacionet e mëposhtme:
 - 3.1. Datën dhe vendin e inspektimit;
 - 3.2. Rezultatet e inspektimeve dhe detajet e defekteve të zbuluara;

- 3.3. Vlerësimin nëse ka ndonjë shqetësim në lidhje me inaugurimin e kurseve me litar, dhe nëse po, detajet e inspektimeve të nevojshme pasuese;
- 3.4. Emrin, adresën dhe nënshkrimin e inspektorit.

Neni 13 **Inspektimi periodik**

1. Për të përcaktuar nivelin e përgjithshëm të sigurisë së pajisjeve, themelit dhe sipërfaqes së kursit me litar, inspektimi periodik duhet të kryhet nga një trupë inspektuese, tipi A, në përputhje me standardin SK EN ISO/IEC 17020 ose një inspektor i certifikuar nga ERCA, të paktën çdo vit kalendarik dhe me interval maksimal 15 mujor, në bazë të kërkesave të përcaktuara me SK EN 15567.
2. Inspektimi periodik i kurseve me litar të përhershëm, të instaluar në drunjë duhet të bëhet të paktën një herë në vit nga një trupë inspektuese me përvojë dhe njohuri mbi kurset e litarve, drunjëve dhe trungjeve.
3. Si pjesë e inspektimeve periodike do të përgatitet një raport që përmban informacionet e mëposhtme:
 - 3.1. Data dhe vendi i inspektimit.
 - 3.2. Personi që ka kryer inspektimin.
 - 3.3. Përmbledhje e asaj që është inspektuar.
 - 3.4. Rezultatet e inspektimit tregojnë ndonjë defekt të vërejtur.
 - 3.5. Rekomandimet për çdo veprim korrigjues.
 - 3.6. Çdo dyshim në lidhje me përdorimin e mëtejshëm të ndonjë pjese të objektit.
 - 3.7. Rekomandimi për ri-inspektim.
 - 3.8. Kopja e raportit të inspektimit, e cila duhet të ruhet me dokumentacionin teknik të veprimtarisë të kurseve me litar.

Neni 14 **Inspektimi i jashtëzakonshëm**

1. Inspektim i jashtëzakonshëm nënkupton verifikimin e kryer nga një trupë inspektuese ose inspektor i certifikuar në rastin kur ka modifikime të mëdha të kursit me litar ose me rastin e ndodhjes së aksidentit. Inspektimin e jashtëzakonshëm mund ta kërkoj pronari ose organet shtetërore.
2. Inspektimi i jashtëzakonshëm përfshin kryerjen e kontrolleve të mëposhtme:
 - 2.1. Inspektimin vizual;
 - 2.2. Inspektimet funksionale;
 - 2.3. Verifikimin se kursi me litar është ndërtuar në përputhje me skicat e modifikimit.
3. Për inspektimin jashtëzakonshëm do të përgatitet një raport inspektimi që përmban informacionet e mëposhtme;

- 3.1. Datën dhe vendin e inspektimit;
- 3.2. Rezultatet e inspektimeve dhe detajet e defekteve të zbuluara;
- 3.3. Emrin, adresën dhe nënshkrimin e inspektorit.

Neni 15 **Inspektimi i Drunjëve**

1. Nëse drunjtë janë pjesë ose në afërsi të aktiviteteve aventureske mbi tokë, ato inspektohen para ndërtimit në përputhje me kerkesat e përcaktuar me SK EN 15567.
2. Drunjtë do të inspektohen të paktën çdo vit kalendarik dhe me një interval maksimal prej 15 muajsh.

Neni 16 **Inspektimi Operacional**

1. Inspektimi operacional duhet të kryhet dhe dokumentohet nga operatori çdo 1-3 muaj ose sipas udhëzimeve të ndërtuesit, ndërsa gjatë inspektimit operacional, duhet të merren parasysh rekomandimet e ndërtuesit në pajtim me SK EN 15567.
2. Inspektimi operacional përfshin pastërtinë, gjendjen e sipërfaqes së tokës, skajet e mprehta, komponentët që mungojnë, vjetërsimi i tepërt (i pjesëve lëvizëse) dhe integriteti strukturor i sistemit të sigurisë (p.sh. gjendja e kablove të çelikut) dhe përcakton shkallën e kalbjes në një shtyllë druri, dhe vendimi nëse është i pranueshëm bazuar në standardet e industrisë.

Neni 17 **Inspektimi vizual rutinor**

1. Inspektimi vizual rutinor bëhet dhe dokumentohet nga operatori para hapjes së kursi me litar, çdo ditë përpara se të përdoret. Inspektimi vizual rutinor përfshin një vëzhgim vizual të komponentëve kritikë dhe një vlerësim të pamjes së përgjithshme të kursit dhe mjedisit përreth.
2. Gjatë inspektimit vizual rutinor duhet të merren parasysh elementët e mëposhtëm për inspektim:
 - 2.1. Dëmtimet nga moti (erërat e forta, rrufeja, etj.);
 - 2.2. Vandalizmi;
 - 2.3. Dëmtimi nga kafshët;
 - 2.4. Vjetërsimi dhe amortizimi.
3. Inspektimet vizuale rutinore duhet të jenë në përputhje me:
 - 3.1. Manualin e mirëmbajtjes, i ofruar nga ndërtuesi.
 - 3.2. Udhëzime për çdo PPM dhe pajisje sigurie.

3.3. Vlerësimi i rrezikut nga operatori.

Neni 18

Autoriteti përgjegjës për inspektimin inaugurues, periodik dhe të jashtëzakonshëm

1. Inspektimi inaugurues i kurseve me litar duhet të kryhet nga një trupë inspektuese i certifikuar, (tipi A, në përputhje me standardin SK EN ISO/IEC 17020).
2. Inspektimi periodik dhe i jashtëzakonshëm i kurseve me litar mund të kryhet nga një inspektor i certifikuar ose nga trupa inspektuese të certifikuara, (tipi A, në përputhje me standardin SK EN ISO/IEC 17020).
3. Trupat inspektuese duhet të jenë të akredituara ose të certifikuara në përputhje me standardin SK EN ISO/IEC 17020.
4. Inspektori duhet të jetë person kompetent i kualifikuar përmes trajnimit/certifikimit, si p.sh. arritja e certifikimit për inspektim nga Shoqata Evropiane e Kurseve të Litarve (ERCA – European Ropes Course Association) ose nga ndonjë organizatë e certifikuar ose akredituar nga Shoqata Evropiane e Kurseve në Litar.
5. Një person kompetent ose organizatë që përmbushë këto kualifikime do të konsiderohet inspektor i aprovuar. Inspektimet e ofruara nga operatorët, të kryera nga individë apo organizata që përmbushin kualifikimet e përcaktuara në këtë nen, do të shqyrtohen për pranim nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Industrisë.

Neni 19

Inspektimi i Via Ferrata

1. Inspektimi inaugurues, inspektimi periodik si dhe inspektimi i jashtëzakonshëm me qëllim të verifikimit të përdorimit të sigurtë të Via Ferrata duhet të bëhet në bazë të SK EN 16869.
2. Inspektimi inaugurues i Via Ferrata duhet të bëhet nga një trupë inspektuese, tipi A, në përputhje me standardin SK EN ISO/IEC 17020 ose një inspektor i certifikuar nga ERCA para se operatori ekonomik të operojë me Via Ferrata.
3. Inspektimi periodik i Via Ferrata duhet të kryhet nga një trupë inspektuese, tipi A, në përputhje me standardin SK EN ISO/IEC 17020 ose një inspektor i certifikuar nga ERCA, të paktën çdo vit kalendarik, zakonisht në fillim të sezonit të përdorimit të Via Ferrata.
4. Inspektimi i jashtëzakonshëm i Via Ferrata kryhet në bazë të dispozitave të nenit 14 të këtij Udhëzimi Administrativ.
5. Inspektimi operacional i Via Ferrata kryhet në bazë të dispozitave të nenit 16 të këtij Udhëzimi Administrativ.

6. Inspektimi rutinor i Via Ferrata kryhet në bazë të dispozitave të nenit 17 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 20

Certifikata e Inspektimit dhe Disponueshmëria për Publikun

1. Nëse, pas inspektimit inaugurues dhe periodik, konstatohet se një kurs me litar është në përputhje me rregullat e këtij Udhëzimi Administrativ dhe me kërkesat e standardit SK EN 15567, Operatori ka të drejtë të vazhdojë me operimin e kurseve me litar.
2. Kopja e certifikatës, e cila tregon datën e fundit të inspektimit, vendoset në portën e kurseve me litar në momentin e lëshimit të saj, ose në secilin vend tjetër të vendosur nga organi kompetent inspektues.
3. Trupa inspektuese ose Inspektori është i obliguar ta dorëzoj në Ministrinë e Industrisë, Ndermarresisë dhe Tregtisë, listën me inspektimet e kryera për kurset me litar duke treguar pronarin e shërbimeve turistike, datën e inspektimit, dhe lëshimin ose jo të Certifikatës, brenda tri (3) ditëve pas lëshimit të asaj certifikate.

Neni 21

Njoftimi për lëndime të rënda fizike ose me fatalitet, hetimet dhe të dhënat e disponueshme për publikun

1. Operatori i kurseve me litar duhet të njoftojë inspektoratin kompetent jo më vonë se njëzet e katër orë pas çfarëdo fataliteti ose aksidenti të ndodhur si rezultat i operimit të kurseve me litar, që rezulton në një lëndim të rëndë fizik të ndonjë personi që kërkon trajtim mjekësor ose që rezulton në humbje të vetëdijes së ndonjë personi.
2. Njoftimi i Inspektoratit kompetent mund të jetë verbal, me shkrim ose me mjete elektronike, por kjo kërkesë e njoftimit në asnjë mënyrë nuk kufizon përgjegjësinë e operatorit për të njoftuar personelin e emergjencës dhe atë të zbatimit të ligjit për incidentin sa më shpejt që të jetë praktikisht e mundur.
3. Inspektorati kompetent heton çfarëdo fataliteti ose aksidenti, dhe çdo ankesë lidhur me sigurinë që përfshin.
4. Secili operator i kursit me litar duhet të mbajë shënime për çdo aksident ose fatalitet, ndërsa shënimi do të mbahet me certifikatën e inspektimit të kërkuar nga ky nen, dhe duhet të jetë lehtësisht i qasshëm për publikun për inspektim gjatë çdo kohe të arsyeshme në vendin ku ndodhet kursi me litar.

Neni 22

Mbikëqyrja e zbatimit të shtojcës së Udhëzimit Administrativ

1. Zbatimi i këtij Udhëzimi Administrativ do të mbikëqyret nga Inspektorati i Tregut.

2. Kur Inspektorati i Tregut pranon certifikatën e inspektimit që tregon ndonjë defekt të kurseve me litar, që mund të rrezikojë sigurinë e pjesëmarrësit, Inspektorati i tregut ndërmerr të gjitha masat e duhura për ta nxjerrë nga shërbimi atë kurs me litar, dhe ndalon përdorimin e tij.
3. Inspektorati i Tregut urdhëron, me shkrim, ndërprerjen e përkohshme të operimit të kurseve me litar nëse pas inspektimit është konstatuar se është i rrezikshëm ose i pasigurt ose që Operatori ka dështuar në kryerjen e inspektimit inauguruës dhe periodik të përcaktuar me këtë Udhëzim Administrativ. Operimi nuk mund të rifillojë derisa të korrigjohen të gjitha parregullsitë.
4. Inspektorati i Tregut e vendos “shenjën e ndalimit të përdorimit” në kursin me litar, përdorimi i së cilit nuk është i sigurt, dhe i lëshon operatorit një vendim për ndalimin e përdorimit të këtij kursi me litar. Operatori duhet të respektojë vendimin e lëshuar nga inspektorati, edhe nëse parashtron ankesë dhe mban përgjegjësi, vendoset “shenja e ndalimit të përdorimit” në portën e kursit me litar.
5. “Shenja e ndalimit të përdorimit” mund të hiqet vetëm nga Inspektorati i Tregut ose trupa e emëruar, ose nga mirëmbajtësi në rast se kërkohet ndonjë riparim. Personi që heq shenjën e “ndalimit të përdorimit” duhet të njoftojë menjëherë Inspektoratin i Tregut për këtë, dhe të ndalojë përdorimin e kursit me litar deri në kryerjen e kontrollit të jashtëzakonshëm.
6. Inspektorati i Tregut i lëshon operatorit vendimin ose ndalimin e përdorimit të kursit me litar, dhe ndërmerr masat e duhura në përputhje me Nenin 56 të Ligjit Nr. 06/L-06-041 për Kërkesat Teknike të Produkteve dhe Vlerësimin e Konformitetit, duke marrë parasysh parimin e proporcionalitetit.

Neni 23

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Përderisa në Kosovë nuk ka ndonjë trupë inspektuese të akredituar dhe të autorizuar sipas Udhëzimit Administrativ nr. 12/18 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit, me kompetencë për të kryer inspektimin inauguruës të kurseve me litar sipas dy (2) pjesëve të standardit SK EN 15567, inspektimi inauguruës do të kryhet nga Trupat Inspektuese të certifikuara nga Shoqata Evropiane e Kurseve në Litar.
2. Përderisa në Kosovë nuk ka ndonjë trupë inspektuese të akredituar dhe të autorizuar sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 12/18 për Mënyrën e Emërimit të Trupave për Vlerësim të Konformitetit, me kompetenca për të kryer inspektime periodike dhe të jashtëzakonshme të kurseve me litar sipas dy (2) pjesëve të standardit SK EN 15576, inspektimi periodik dhe të jashtëzakonshme do të kryhet nga Trupat Inspektuese të certifikuara nga ose Inspektori i certifikuar nga Shoqata Evropiane e Kurseve të Litarve.
3. Operatorët që kanë filluar me operimin e kurseve me litar para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, por që nuk kanë kryer ende inspektimin inauguruës, janë të detyruar ta kryejnë këtë inspektim brenda gjashtë muaj (6) muajve nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi Administrativ.

4. Shoqatat profesionale të turizmit dhe shoqëritë tregtare që merren më ofrimin e veprimtarisë së shërbimeve të turizmit aktiv dhe aventuror për zbatimin e standardeve të cekura në këtë Udhëzim Administrativ vlejnë standardet në fuqi ose ekuivalentet e tyre.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

SHTOJCA II

FORMULARI I RAPORTIMIT TË AKSIDENTEVE DHE INCIDENTEVE

RAPORTUAR NGA: _____ DATA E RAPORTIMIT: _____

FUNKSIONI/POZITA: _____ Nr. I INCIDENTIT/AKSIDENTIT: _____

INFORMATA RRETH INCIDENTIT/AKSIDENTIT

LLOJI I INCIDENTIT/AKSIDENTIT: _____

DATA E NDODHJES: _____

VENDNDODHJA (Adresa): _____

PËRSHKRIMI I INCIDENTIT/AKSIDENTIT

EMRI DHE MBIEMRI / KONTAKTET E PALËVE TË PËRFSHIRA

1. _____
2. _____
3. _____

EMRI DHE MBIEMRI / KONTAKTET E DËSHMITARËVE

1. _____
2. _____
3. _____

RAPORTUAR NË POLICI: _____

DATA E RAPORTIMIT NË POLICI: _____

VEPRIME PËRCJELLËSE

INFORMATA TJERA (përveç të dhënave të kërkuara më lartë mund të shtohen informata shtesë sipas rasteve)

EMRI DHE MBIEMRI I MBIKËQYRËSIT: _____

NËNSHKRIMI: _____ DATA: _____



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

SHTOJCA III

REGJISTRI I INSPEKTIMIT DITOR - VIA FERRATA

Kontrolloni përpara se të përdorni Via Ferrata (emri i Via Ferrata):

Data dhe vendndodhja:

Emri dhe nënshkrimi i inspektorit:

Emri dhe nënshkrimi i asistentit (nëse është e aplikueshme):

Kushtet atmosferike:

- Kontrolloni gjendjen e kabllave, karabinave dhe ankorimeve.
- Kërkoni për shenja ndryshku, konsumimi ose dëmtimi.
- Sigurohuni që kabllot të jenë të shtrënguara siç duhet dhe ankorimet të jenë të sigurta.
- Inspektoni gjendjen e shkallëve dhe urave sa i përket stabilitetit të tyre.
- Kontrolloni nëse ndonjë këmbë e shkallëve (ang. rungs and steps) nuk është e shtrënguar ose ka ndonjë pjesë që lëvizë.
- Kërkoni për shenja ndryshku ose dëmtimi.
- Verifikoni gjendjen e pajisjeve të sigurisë personale.

- Kontrolloni rripat e sigurisë (parzmoret), helmetat dhe konopët (ang. lanyard) nëse janë konsumuar.
- Sigurohuni që karabinat dhe hallkat (ang. slings) të jenë në gjendje të mirë.
- Kontrolloni që shënjesit e rrugës, paralajmërimet dhe udhëzimet të jenë të qarta.
- Sigurohuni që të gjitha tabelat të jenë të padëmtuara dhe të lexueshme.
- Vëzhgoni ndikimin në mjedis.
- Sigurohuni që të mos ketë mbeturina apo dëmtime në zonën përreth.
- Verifikoni që ngjitësit janë duke përdorur pajisjet e duhura.
- Shmangni mbipopullimin në shteg.
- Inspektoni shtegun dhe pikat e hyrjes.
- Hiqni gurët e lirshëm ose mbeturinat që mund të përbëjnë rrezik.
- Regjistroni çdo problem, vëzhgim ose rekomandim.
- Shënoni çdo veprim të ndërmarrë ose të planifikuar për mirëmbajtje ose riparime.

Vërejtjet e inspektorit:

INFORMATA TJERA (përveç të dhënave të kërkuara më lartë mund të shtohen informata shtesë sipas rasteve)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

SHTOJCA IV

REGJISTRI I INSPEKTIMIT DITOR – PARKU I AVENTURAVE

Kontrolloni përpara se të përdorni (emri i Parkut të aventurave):

Data dhe vendndodhja: _____

Emri dhe nënshkrimi i inspektori: _____

Kushtet atmosferike: _____

- Kontrolloni të gjitha litart, rripat e sigurisë (parzmoret), karabinat, rrotullat (ang. pulleys), helmetat dhe pajisjet e tjera nëse ka shenja të konsumimit, dëmtimit ose defektit.
- Verifikoni që të gjitha pajisjet janë të shënuara siç duhet dhe numrat serik përputhen me të dhënat për mirëmbajtje dhe inspektime.
- Inspektoni pikat e ankorimit (pemët, shtyllat, strukturat) për t'u siguruar që ato janë të sigurta dhe në gjendje të mirë.
- Kontrolloni pikat e lidhjes (bulonat, karabinat, hallkat) për t'u siguruar që ato janë të lidhura siç duhet dhe të padëmtuara.
- Ecni në të gjithë kursin e litarve dhe kontrolloni çdo element për ndonjë shenjë dëmtimi, konsumimi ose problem strukturore.
- Kërkoni nëse ka ndonjë kablo të qeruar, pajisje harduer jo të shtrënguar mirë ose platforma jostabile.

- Verifikoni që rrjetat e sigurisë dhe barrierat janë të vendosura dhe të sigurta.
- Monitoroni kushtet atmosferike për t'u siguruar që ato janë të përshtatshme për aktivitetet e kursit me litar. Shmangni erërat e forta, stuhitë dhe kushtet tjera të pafavorshme atmosferike.
- Numri i vizitorëve.

Vërejtjet e inspektorit:

INFORMATA TJERA (përveç të dhënave të kërkuara më lartë mund të shtohen informata shtesë sipas rasteve)



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

SHTOJCA V

REGJISTRI I INSPEKTIMIT DITOR – ZIP LINE

Kontrolloni përpara se të përdorni Zip Line (Emri i Zip Line):

Data dhe vendndodhja: _____

Emri dhe nënshkrimi i inspektorit: _____

Kushtet atmosferike: _____

- Kontrollimi i terenit (pikat e mundshme penguese, gurë të mprehtë, rrënjë, borë, akull ...)
- Kontrollimi i shtrëngimit.
- Kontrollimi i kabllor kryesore të sigurisë.
- Kontrollimi i kabllor mbështetëse.
- Kontrollimi i pajisjes së frenimit ZipStop.
- Kontrollimi i drunjëve (A ka ndonjë gjë mbi zipline? (p.sh degë).
- Kontrollimi i PPM.
- Kushtet atmosferike.
- Numri i vizitorëve.

Vërejtjet e inspektorit:

--

INFORMATA TJERA (përveç të dhënave të kërkuara më lartë mund të shtohen informata shtesë sipas rasteve)

--



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

SHTOJCA VI

Datë: ____ / ____ / ____

Prot.: _____,

KËRKESË PËR
REGJISTRIM TË SHOQËRISË TREGTARE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË
TURIZMIT AKTIV DHE AVANTUROR NË REGJISTRIN E TURIZMIT

Të dhënat e shoqërisë tregtare:

Emri i shoqërisë tregtare: _____

Numri i regjistrimit: _____

Emri i personit të autorizuar: _____

Adresa e selisë: _____

E-Mail: _____

Nr. Telefonit: _____

Të dhënat për përfshirje në regjistrin e turizmit dhe publikim:

Nr.	Përshkrimi i të dhënave që do të bëhen publike në regjistrin e turizmit	Plotëso
1	Emri zyrtar shoqërisë tregtare (biznesit);	
2	Të dhëna për adresën e ushtrimit të veprimtarisë;	
3	Informacione kontakti;	

4	Linku i subjektit në web faqen e Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK);	
6	Kapaciteti për vizitorët (numri i pjesëmarrësve) që mund të përdorin shërbimet në të njëjtën kohë	
7	Llojin e shërbimeve që ofrojnë, sipas nenit 37 të ligjit për turizëm:	Plotëso me <input checked="" type="checkbox"/> shërbimet që ofroni (<i>mund të zgjidhni një ose më shumë shërbime</i>)
7.1	ngjitja;	
7.2	ecja në zona malore;	
7.3	çiklizmi malor;	
7.4	parashutizmi;	
7.5	alpinizmi;	
7.6	lundrimi në ujëra të rrëmbyeshme;	
7.7	lundrimi me kajak;	
7.8	aktivitetet speleologjike;	
7.9	aktivitetet e kalërimit;	
7.10	rrëshqitja në litar dhe kurseve me litar;	Zip Line <input type="checkbox"/> Park i Aventurave <input type="checkbox"/>
	Tjetër	

Aplikuesi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

SHTOJCA VII

Datë: ____ / ____ / ____
Nr. Prot.: _____

KËRKESË PËR
REGJISTRIM TË SHOQATAVE PROFESIONALE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE
TË TURIZMIT AKTIV DHE AVANTUROR NË REGJISTRIN E TURIZMIT

Të dhënat e shoqatës:

Emri i shoqatës: _____

Numri i regjistrimit: _____

Emri i personit të autorizuar: _____

Adresa e selisë: _____

Email: _____

Nr. Telefonit: _____

Të dhënat për përfshirje në regjistrin e turizmit dhe publikim:

Nr.	Përshkrimi i të dhënave të shoqatës që do të bëhen publike në regjistrin e turizmit	Plotëso
1	Emri zyrtar i shoqatës;	
2	Fushën e turizmit që mbulon shoqata	
3	Qëllimin e shoqatës dhe aktivitetet	

4	Të dhëna kontaktuese për shoqatën	
5	Linku i subjektit në internet	
6	Tjera	
7	Kapaciteti për vizitorët (numri i pjesëmarrësve) që mund të përdorin shërbimet në të njëjtën kohë	
8	Llojin e shërbimeve që ofrojnë, sipas nenit 37 të ligjit për turizëm:	Plotëso me <input checked="" type="checkbox"/> shërbimet që ofroni (<i>mund të zgjidhni një ose më shumë shërbime</i>)
8.1	ngjitja;	
8.2	ecja në zona malore;	
8.3	çiklizmi malor;	
8.4	parashutizmi;	
8.5	alpinizmi;	
8.6	lundrimi në ujëra të rrëmbyeshme;	
8.7	lundrimi me kajak;	
8.8	aktivitetet speleologjike;	
8.9	aktivitetet e kalërimit;	
8.10	rrëshqitja në litar dhe kurseve me litar;	Zip Line <input type="checkbox"/> Park i Aventurave <input type="checkbox"/>
	Tjetër	

Aplikuesi
